



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
Njesia e Zbatimit te Projekteve

Adresa: Blvd."Bajram Curri", Tiranë – Shqipëri, Tel/Fax: +355 4 364781 E-mail: eshehu@moh.gov.al

Tirane me, 07 Maj 2009

INFORMACION

*Per Projektet qe ka Ministria e Shendetesise
me
Banken per Zhvillim te Keshillit te Europes (CEB)*

Banka per Zhvillim e Keshillit te Europes (CEB), ne bashkefinansim me Qeverine shqiptare sektorin e Shendetesise, po zbaton disa projekte shume te rendesishem si me poshte:

A- TIRANA

- 1- **Faza e Pare e QSUT-se:** Vlera e Projekti 21.4 Milion Dollare Amerikane. Vlera e komponentit te ndertimit 20.25 Milion Dollare Amerikane. Nga ketu CEB-i financon 63% te komponentit te ndertimit dhe Qeveria Shqiptare 37%. Projekti eshte bere efektiv ne fund te vitit 2005 dhe planifikohet te mbaroje ne Gusht-Shtator te vitit 2009.

Në këtë Fazë të Parë po ndertohej një spital i ri, ku do të vendosen departamenti i urgjencës, reanimacionit, imazherisë, laboratorët si dhe mjekësia e brendshme. Gjithashtu kjo fazë përfshin edhe ndërtimin e godinës së shërbimeve ndihmëse, elektriko- mekanike, si dhe ndërtimin e një tuneli që do të bëjë lidhjen e këtyre shërbimeve me spitalin e ri.

Nderkohe Ministria e Shendetesise ka filluar procedurat e tenderimit per blerjen e pajisjeve dhe furniturave mjekesore per kete spital, te cilat jane nga me bashkekohoret, si dy skaner, angeograf, pjisjet e reanimacionit, te laboratoreve, te sterilizimit, etj. Vlera e tyre eshte mbi 8 Milion Euro dhe financohen nga buxheti i shtetit. Venia ne perdorim e tyre parashikohet te behet para fundit te vitit ne vazhdim.

- 2- **Faza e Dyte e QSUT-se.** Nje Projekt Propzim per financimin e Fazes se II-te te QSUT-se eshte pergatitur nga Ministria e Shendetesise per Ministrine e Financave e cila do te aplikojte per kredi te bute, prane Bankes se Keshillit te Europes (CEB).

Gjithashtu është detajuar edhe vlera e kredisë që do të kërkohet CEB-it (rreth 25 Milion Euro) si dhe kontributi i qeverise tonë (rreth 28 Milion Euro). Ndërkohë për këtë projekt është siguruar nga CEB-i edhe një grant prej 580 Mijë Euro, i cili do të mbulojë tre studimet (i) përmirësimin e Master-Planit (ii) studimin e ndikimit në mjedis (iii) studimin energjistik. Pra vlera totale e Projektit është rreth 54 Milion Euro, se bashku me teknologjine mjekesore.

Eshte ne pritje pjesemarrja ne financim prej Fondit OFID (OPEC Fund for International Development), me rreth 22 Milion Euro (Hua + Grant). N.q.s. do te realizohet ky financim, kjo vlere do te zbritet nga kontributi i Qeverise Shqiptare.

Punimet që parashikohen të kryhen janë rreth 27 mijë m² ku është menduar: Reanimacioni i përgjithshëm, ai Kirurgjikal, Kirurgjia ditore, Radioterapia, Onkologjia, Diagnostika funksionale, Dializa dhe Departamenti i pacientëve ambulatorë.

B-SHKODRA

Nderhyrjet ne spitalin rajonal te Shkodres, jane lehtesuar nga pergatitja e Master-Planit, paraprakisht ne vitin 1996, nga studio konsulente gjermane TOP Consult, Koln, financuar nga Projekti i Pare i Bankes Boterore. Kjo mundeson nderhyrjet, si te investitoreve te huaj ose te qeverise shqiptare, te cilet e dine tashme se ku duhen kanalizuar investimet per kete spital.

Ne fazen e pare te Projektit te Spitalit Rajonal te Shkodres u realizua ndertimi i Urgjences, Kirurgjise me 5 salla operacioni, Reanimacionit dhe sherbimeve ndihmese. Pas perfundimit te kesaj Faze, ne vitin 1996, te financuar nga Banka Boterore, CEB-i shprehu interesin per te financuar fazen e dyte dhe te trete te tij:

Faza e dyte e Projektit te Spitalit Rajonal te Shkodres, perfundoi ne vitin 2007, nepermjet nje bashkefinancimi te CEB-it (2.4 Milion Dollare Amerikane) dhe Qeverise Shqiptare (2.4 Milion Dollare Amerikane, ku perfshihet edhe blerja e pajisjeve mjekesore). Ne kete faze, sipas master-planit, u realizua rehabilitimi i pergjithshem i spitalit obsetrik-gjinekologjik, si dhe ndertimi i ri i departmentit te imazherise.

Faza e Trete e Projektit te Spitalit Rajonal te Shkodres. Kjo eshte nderhyrja e fundit e parashikuar ne Master-Plan. Projekti ka nje vlere prej 10.48 Milion Euro, pa perfshire TVSH-ne. dhe tashme ka filluar zbatimi i tij.

Plani i Financimit:	Huaja e CEB-it	6. 000 000 Euro
	Grant i CEB-it	150 000 Euro
	Republika e Shqiperise	4.330 000 Euro
	Grafiku kohor i puneve:	2008-2011

Zona e ndërhyrjes: Projekti synon vazhdimin e rehabilitimit të Spitalit të Shkodrës, duke u bazuar ne kete Master Plan.

Punët e planifikuara: Punët kryesore të planifikuara të fazës së tretë do të jenë:

- (i) Ndërtimi i ri i mjediseve të përshtatshme për pacientët akute dhe kronikë të psikiatrisë, gjatë vitit të parë të zbatimit;
- (ii) Integrimi i poliklinikës së qytetit, në zonën spitalore (me rreth 15-17 shërbime);
- (iii) Organizimi i një rrjedhe të logjikshme të punës dhe të shërbimeve;
- (iv) Përmirësimi i regjistrimit dhe menaxhimit.

Efektet sociale: Spitali Rajonal i Shkodrës është qendra më e rëndësishme shëndetësore për pacientët e shtruar dhe ata ambulatorë në zonen e veriut. Perfundimi i këtij Projekti do të përmirësojë aksesin e kujdesit shëndetësor për banorët e qarkut të Shkodrës dhe të rrethinave, duke garantuar një sistem kujdesi shëndetësor të efektshëm dhe të qëndrueshëm. Menjëherë pas

përfundimit të fazës së tretë, spitali do të zbatojë kritere të reja të shërbimeve shëndetësore dhe do të përfshijë një bashkërendim të mirë ndërmjet shërbimeve të specializuara, një dizenjo të përshtatur ndaj nevojave të pacientit dhe të personelit, një fleksibilitet të gjerë për ndryshime të mundshme, standarde të përshtatshme të kujdesit; të gjitha këto në interesin më të mirë të pacientëve të shtruar dhe ambulatorë prej Qarkut të Shkodrës.